



Raport monitorues XII-të

mbi punën e ekzekutivit të komunës së

Lipjanit

Dhjetor 2015

Përmbajtja:

- Hyrje,
- Përmbledhje ekzekutive,
- Premtimet e Kryetarit Imri Ahmeti,
- Problemet aktuale,
- Transparenca dhe llogaridhënia
- Performanca buxhetore e komunës së Lipjanit
- Drejtoria e prokurimit
- Administrata komunale
- Arsimi
- Shëndetësia
- Tatimi në pronë
- Burimet:

Adresa: Rr."Dr. Avdi Avdiu" 14000 Lipjan

Tel.+377 (0) 44 786 414 & +386 (0)49 823 140

e-mail: info.yahr@gmail.com

Ueb faqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>

<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>

Facebook: <https://www.facebook.com/YAHR.Kosovo>

"Ky projekt u financua përmes grantit të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center"




Organizata Joqeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit ,gjatë periudhës katër vjeçare 2013/2017 dhe do të dal me raporte monitoruese-vlerësuese për çdo gjashtë muaj.

Youth Association for Human Rights /YAHR që nga vitit 2009 është duke bërë monitorimin pro aktiv të punës së ekzekutivit të Komunës së Lipjanit. Në monitorimin e punës së ekzekutivit të Komunës së Lipjanit për periudhën gjashtë mujore, nëpërmes këtij raporti YAHR provon të kontribuoj në ofrimin e informacioneve të strukturuar të cilat do të jenë në shfrytëzim, para së gjithash për qytetarin e Komunës së Lipjanit, shoqërinë civile, mediat, si dhe vetë institucionin e monitoruar, ekzekutivin e Komunës së Lipjanit. Në këtë drejtim, në formë të renditur nëpërmes këtij raporti ofrojmë të dhëna të cilat pasqyrojnë disa aspekte të punës së ekzekutivit. YAHR nëpërmjet monitorimit pro aktiv dhe por edhe në bashkëpunim me institucionin e Kuvendit si dhe palë të përfshira në këtë proces, YAHR ka arritur t'i siguroj këto informacione, të cilat do të mund të zhvilloheshin edhe më tej, në rast të një bashkëpunimi më cilësor nga ana e institucioneve, apo edhe në rast të organizimit dhe funksionimit të tyre më të mirëfilltë. Nëpërmes aktiviteteve monitoruese YAHR është përfshirë në këto drejtime si puna në seanca plenare dhe puna në Komitetet.

Në hartimin e këtij raporti të dymbëdhjetë monitorues për punën e ekzekutivit të Kuvendit komunal të Lipjanit, YAHR është mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimin e aktiviteteve të drejtorëve, monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të mediave të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

Bekim Krasniqi

Drejtor ekzekutiv i YAHR-it



Hyrje

OJQ Youth Association for Human Rights (YAHR) për gjatë pjesës së parë të vitit 2015 nëpërmjet monitoruesve të saj nga afër ka përcjellë punën e ekzekutivit si dhe funksionimin e legjislativit të komunës së Lipjanit. Ky monitorim ka pasur për qëllim të identifikojë jo vetëm të metat eventuale të qeverisjes si dhe shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi por edhe të shënojë ngritjen e institucioneve si në aspektin e rritjes së kapaciteteve, shfrytëzimit të buxhetit dhe aplikimit të frymës demokratike të marrjes së vendimeve si dhe të komunikimit dhe të transparencës. Gjatë procesit të monitorimit YAHR-i ka synuar të rrisë besueshmërinë e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes por edhe të sigurojë një prani të përhershme të një mbikëqyrje transparente të funksionimit të pushteteve me theks të veçantë të transparencës në raport me qytetarin. Duke u nisur nga bindja se procesi i monitorimit është i domosdoshëm për këtë shkallë të zhvillimit të demokracisë sonë, derisa ende institucionet tona përballen me ngërçe institucionale dhe me mos- transparencë, YAHR-i konsideron se me punën e monitorimit është mundësuar një dobi e dyfishtë edhe në raport me institucionet por edhe me qytetarin. Institucionet komunale kanë pasur mundësi të dëgjojnë një zë jo kundërshtues apo refuzues arbitrar, por një zë të këshillës dhe të sugjerimit për të avancuar proceset. Ndërkaq qytetari ka fituar një zë të sigurt, një vlerësim bindës për zhvillimet brenda institucioneve komunale duke mësuar kështu më mirë se kah dhe ku harxhohet paraja publike, apo si janë caktuar prioritetet e projekteve. Gjatë punës së tij YAHR-i ka hasur edhe në bashkëpunime të hapura të sinqerta dhe transparente dhe shih për këtë i falënderon të gjithë ata që kanë ofruar të dhëna dhe sqarime në çdo moment, për ne shumë të nevojshme dhe të domosdoshme për të kryer misionin tonë prej monitoruesi.

Vendimmarrja e cila prekë interesat e qytetarëve duhet të merret sa më afër tyre, këtë e siguron parimi i subsidiaritetit. Kjo u mundëson qytetarëve që të përfitojnë shërbime publike më të mira dhe në mënyrë më efikase dhe transparente nga organet komunale.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t'iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave

Përmbledhje ekzekutive

Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit bazuar në monitorimin e punës së Komunës së Lipjanit gjatë periudhës Qershor-Dhjetor 2015. Monitorimi është fokusuar në Ekzekutivin e Komunës, dhe përfshinë fushat: e premtimeve të kryetarit të komunës, transparencës dhe llogaridhënies, demokratizimit dhe qeverisjes së mirë, zhvillimit urban e ekonomik, arsimit dhe shëndetësisë. YAHR-i gjatë përpilimit të këtij raporti është bazuar në bazë të informatave të mbledhura në teren nga qytetarët, nga raportet mujore dhe vjetor të kryetarit për vitin 2014, nga monitorimi i drejtpërdrejtë të aktiviteteve të punës së ekzekutivit, nga mediat dhe nga shumë informacione të ndryshme.

Ekzekutivi i Komunës së Lipjanit gjatë kësaj periudhe Janar - Dhjetor 2015 është përballur me shumë vështirësi. Vështirësitë më të cilat është përballur ekzekutivi i Komunës së Lipjanit janë: obligimet e trashëguara nga ekzekutivi i kaluar, ekzekutimi i disa vendimeve nga ana e Thesarit Qendror dhe të institucionet gjyqësorit dhe deri te anulimi i disa tenderëve nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Në këtë raport monitorues kemi paraqitur edhe performancën e kryetarit të Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti lidhur me përmbushjen e premtimeve gjatë fushatës zgjedhore për kryetar komune në vitin 2013 i cili kishte premtuar 131 projekte konkrete për 62 vendbanime të Komunës së Lipjanit. Ku nga 131 premtime të premtuar me projekte konkrete gjatë fushatës në zgjedhjet lokale 2013 për kryetar të komunës së Lipjanit, kemi vetëm 46 premtime / projekte ose 35.22 %, që ka lëvizje për realizimin e tyre, ku nga këto 46 projekte, kemi vetëm 16 premtime të realizuara plotësisht ose 12.20 %, ndërsa 85 premtime ose 64.88 % nuk kemi asnjë lëvizje konkrete në realizimin e tyre.

Lidhur me transparencën dhe llogaridhënien e ekzekutivit ndaj qytetareve, ende po vazhdohet me një nivel të ultë në këto dy shtylla të qeverisjes së mirë, pasi që kryetari Imri Ahmeti vazhdon të mbajë të mbyllura dyert për organizatat e shoqërisë civile në mbledhjet e Bordit të drejtorëve, kemi ndërprerjen e dërgimit të materialeve të kuvendit për shoqërinë civile, kemi po ashtu kemi mos lejmë në qasjen në dokumentet publike për organizatën e vetëm monitoruese YAHR, kemi mos publikim të vendimeve për ndarje të subvencioneve nga zyra e kryetarit dhe mos publikimi i këtyre vendimeve lindi dyshime për keq përdorim të parasë publike, etj.

Ndërsa, si shenja pozitive për këtë periudhe është vazhdimi i performancës së mirë në arkëtimin e të hyrave vetanake nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe në uljen e obligimeve të borxheve të trashëguara, fillimi i realizimit të projektit nga organizata Helvitas për rregullimin dhe mbjelljen e drunjeve në qytetin e Lipjanit, zgjidhjen e problemit me ujërat e zeza në fshatin Gumnasellë nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Profili i Kryetarit Imri Ahmeti



Imri Ahmeti u lind më 05.08.1964, në fshatin Torlnë, komuna e Lipjanit, shkollën fillore e kreu në fshatin Rufc, ndërsa shkollën e mesme në Lipjan. Është i diplomuar në fakultetin juridik në Universitetin e Prishtinës.

Profesor i Lëndëve Juridike në gjimnazin në Lipjan 1994-1999, Shef i Inspektoratit 1999-2000, Shefi i sektorit për regjistrimin e bizneseve 2004-2007, Kryeshef Ekzekutiv 2004-2007, Këshilltar politik në Kabinetin e Presidentit të Kosovës 2007-2008, Këshilltar i lart politik i Zëvendës së kryeministrit të Qeveris së Kosovës z. Ramë Manaj 2008-2010, zv/ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme në Qeverinë e Republikës së Kosovës 2010, Deputet në Parlamentin e Kosovës 2011-2013, Nga viti 2013 kryetar i Komunës së Lipjanit¹.

Premtimet e Kryetarit Imri Ahmeti

Organizata Joqeveritare **Youth Association For Human Rights – YAHR** kemi monitoruar aktivitetet dhe premtimet e kryetarit Imri Ahmeti, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2013 dhe 7 – 12 dhjetor 2013². Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në debatin e organizuar nga ne dhe gjithashtu nga dy debatet të mbajtura në “Jeta në Kosovë”³, në mes të tjerash Kryetari Ahmet ka premtuar:

Tabela 1: Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit për realizimin e premtimeve.	
0 -regon që asnjë përpjekje ose angazhim konkret nuk është bërë në realizimin e premtimit, 1- tregon se ka shenja pozitive në realizimin e premtimit, 2- tregon një proces të filluar në realizimin e premtimit por me ngecje, 3- tregon për një proces të filluar dhe në rrugë të mirë, 4- tregon se hapa konkrete kanë filluar të ndërmerren për realizimin e premtimit dhe diçka në këtë kontekst është bërë dhe, 5- tregon se realizimi i premtimit është në fazën drejt finalizimit.	vlerësimi ⁴
Lipjan	
Asfaltimi dhe ndërtimi i trotuareve në të gjitha rrugët urbane;	5
Rindërtimi i Sheshit Adem Jashari;	1
Shtimi i hapësirave gjelbëruese dhe mirëmbajtja e atyre ekzistuese;	3
Fasadimi, izolimi dhe restaurimi i ndërtesave në qytet (bashkëfinancim);	0

¹ <https://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/President/Biografia-e-Kryetarit.pdf.aspx>

² <http://zgjedhjet2013.weebly.com/programet-e-partive-politike-peumlr-zgjedhjet-2013.html>

³ <http://zgjedhjet2013.weebly.com/tv-debatet.html>

⁴ <https://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/President/President-Report/Raporti-per-Vitin-2014.pdf.aspx>

Ndriçimi i të gjitha rrugëve, opsioni ndriçimi solar;	3
Ndërtimi i hapësirave të hapura sportive si dhe rregullimi i Stadiumit të qytetit;	0
Ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza;	0
Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve;	0
Ndërtimi i objektit të ri të Komunës	0
Ndërtimi i rrugës për në varrezat e qytetit dhe mirëmbajtja e tyre;	0
Ndërtimin e qendrës zejtare përmes partneritetit publiko privat;	0
Projektimi dhe ndërtimi i nxehtës qendrore përmes partneritetit publiko privat;	0
Dislokimi tregut të gjelbër dhe ndërtimi në një hapësirë të përshtatshme;	0
Rregullimi i shtratit të lumit “Sitnica” dhe përroskës “Janjevka”.	2
Projektet në Gadime të Epërme, Gadime të Ulët, Babush të Muhaxherëve, Vrellëe Gadimes, Plitkoviq, Gllavicë e Marec	
Funksionalizimi i rrjeteve ekzistuese dhe përfundimi ndërtimit të kanalizimit dhe ujësjellësit,	3
Asfaltimi i rrugicave,	5
Asfaltimi i rrugëve deri në varrezat,	4
Ndërtimi i urës dhe asfaltimi i rrugicave në lagjen e ashkalive në Gadime të Ulët,	5
Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi publik në rrugët qendrore, opsion ndriçimi solar.	4
Funksionalizimi dhe pajisja e ambulancës ekzistuese me laborator në Gadime të Epër,	0
Rregullimi i shtratit të lumit dhe ndërtimi i shëtitores në Gadime të Epër dhe në Gadime të Ulët,	5
Ndërtimi i rrugës Gadime- Smallushe- Sllovi,	0
Ndërtimi i shkollës fillore në lagjen e “Ibrajve” në Gadime të Epër;	0
Rregullimi i fushave sportive,	0
Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve për regionin e Gadimes,	0
Gjetja e lokacionit dhe ndërtimi i shkollës fillore në Gadime të Ulët	0
Gjetja e lokacionit për ndërtimin e fushës sportive në Gadime të Ulët,	0
Rregullimi i stadiumit dhe i infrastrukturës përkatëse në Babush të Muhaxhirëve;	0
Rregullimi i nxehtës qendrore dhe ndërtimi i sallës së sportit për shkollën “Ernest Koliqi” në Babush të Muhaxhirëve.	0
Asfaltimi i rrugës Babush – Cernille përmes bashkëpunimit ndër komunal;	0
Projektet në Llugaxhi, Gumnasellë, Çallapek, Banullë, Glllogovc, Rubovc dhe Kojškë	
Ndërtimi i trotuareve,	0
Përfundimi i objektit të sporteve në Llugaxhi,	2
Mirëmbajtja dhe rregullimi i impiantit të ujërave të zeza për fshatrat Llugaxhi, Gumnasellë. Çallapek,	2

Banullë, Rubovc dhe Kojskë;	
Asfaltimi i rrugëve të fshatrave,	5
Përfundimi dhe funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,	3
Ndërtimi i shkollës në Gumnasellë dhe Rubovc si dhe përfundimi i shkolles në Banullë dhe në Glllogovc;	4
Rregullimi i shtratit të lumenjve,	0
Ndërtimi i fushave të sportit,	0
Renovimi i shkollës së vjetër të fshatit Banullë,	0
Projektet në Sllovi dhe Smallushë	
Hapja dhe asfaltimi i rrugës ndërlidhëse ndërmjet dy rrugëve kryesore të fshatit Sllovi;	4
Asfaltimi i rrugës në lagjen e “Abazve” në Sllovi;	4
Asfaltimi i rrugës ndërlidhëse Sllovi- Smallushë;	4
Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve në Sllovi;	0
Ndërtimi i trotuareve dhe i ndriçimit publik-opcion ndriçimi solar;	0
Zgjerimi dhe përfundimi i rrjetit të kanalizimit;	3
Rregullimi i fushës së sportit;	5
Funksionalizimi i QMF.	5
Rregullimi i sallës së sporteve në shkollën e Sllovisë;	0
Renovimi dhe funksionalizimi i shkollës së vjetër në Sllovi;	0
Rregullimi i shtratit të lumenjve;	0
Ndërtimi i rrugës Sllovi – Gjilan në bashkëpunim ndërkomunal;	0
Projektet në Janjevë, Aklap, Teqe, Brus, Tërbufc, Hanroc, Bukovicë, Okosnicë, Shisharkë dhe Vogaçicë	
Asfaltimi dhe ndërtimi i rrugëve të brendshme me kupëza në Janjevë,	5
Përfundimi i asfaltimit të rrugëve në Brus,	5
Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik (opcion ndriçimi solar) në Janjevë,	0
Rregullimi i shtratit të lumit dhe shëtitores në Janjevë,	0
Funksionalizimi i ujësjellësit,	4
Ndërtimi i kanalizimit,	0
Ndërtimi i fushave të sportit,	0
Rregullimi i rrethojës së oborrit të shkollës në Janjevë,	0
Ndërtimi i shkollës në Teqe,	0
Renovimi i shkollës në Brus,	0

Ndërtimi i dy urave në fshatin Akllap,	0
Projektet në Konjuh:	
Asfaltimi i rrugëve të fshatit;	0
Ndërtimi i trotuareve;	4
Ndërtimi i rrethojës së shkollës;	0
Ndërtimi i fushës së sportit;	0
Rregullimi i shtratit të lumit dhe ndërtimi i shëtitores.	0
Projektet në Jetën e Re dhe Grackë e Vjetër	
Zgjerimi dhe funksionalizimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në të dy fshatrat;	0
Asfaltimi i rrugëve dhe ndërtimi i trotuareve në Jetë të Re dhe Grackë e Vjetër;	0
Lidhja e ujërave të zeza të fshatit Jeta e Re dhe Grackë e Vjetër me impiantin e qytetit të Lipjanit;	0
Restaurimi dhe funksionalizimi i shtëpisë së kulturës në Grackë të Vjetër;	0
Projektet në Topliçan, Grackë e Vogël dhe Bujan	
Përfundimi dhe funksionalizimi i kanalizimit.	5
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit,	0
Asfaltimi i rrugëve dhe ndërtimi i trotuareve.	0
Asfaltimi i rrugës lidhëse ndërmjet Topliçanit dhe Grackës së Vogël;	0
Ndërtimi i stadiumit dhe objekteve përcjellëse në Topliçan;	0
Projektet në Bregu i Zi dhe Varigoc	
Ndërtimi i shkollës fillore në Breg të Zi;	0
Ndërtimi i fushës së sportit në Breg të Zi;	0
Asfaltimi i rrugicave në Breg të Zi;	4
Ndërtimi i trotuareve në Breg të Zi;	0
Asfaltimi i rrugës në Varigoc;	0
Asfaltimi i rrugës Varigoc-Godanc	0
Ndërtimi i ujësjellësit dhe kanalizimit ;	0
Projektet në Hallaq i Madh, Hallaq i Vogël, Rufci i Ri, Rufci i Vjetër dhe Ribar i Vogël	
Funksionalizimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,	1
Asfaltimi i rrugicave,	1
Ndërtimi i trotuareve,	3
Ndërtimi i urës mbi lumin Sitnica,	0
Rregullimi i fushave sportive.	0
Projektet në Kraishtë:	


Përfundimi i shkollës me objekte përcjellëse;	5
Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martireve;	0
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit;	0
Përfundimi i asfaltimit të rrugicave;	0
Rregullimi i shtratit të lumit dhe shëtitores në Kraishtë;	0
Ndërtimi i trotuareve,	0
Projektet në Ribari i Madh dhe Zllakuqan	
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit,	0
Asfaltimi i rrugëve,	5
Ndërtimi i trotuareve,	0
Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martireve;	0
Ndërtimi i QMF-se në Ribar të Madh;	0
Ndërtimi i fushës të sportit.	0
Rregullimi i shtratit të lumit dhe shëtitores në Ribar të Madh.	0
Projektet në Torinë, Poturovc, Dobrajë e Madhe, Dobrajë e Vogël, Llugë dhe Gllanicë	
Ndërtimi dhe funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësve dhe kanalizimit,	4
Asfaltimi i rrugëve të fshatrave,	5
Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik*opsion ndriçimi solar),	1
Ndërtimi i stadiumit dhe objekteve përcjellëse në Dobrajë të Madhe,	0
Asfaltimi i rrugëve deri të varrezat e fshatit,	0
Rregullimi i ngrohjes qendrore në objektin e shkollave.	0
Rregullimi i shtratit të lumit dhe ndërtimi i shëtitores në Dobrajë të Madhe,	5
Ndërtimi i rrugës Dobrajë e Madhe – Magure,	0
Rregullimi i rrethojave dhe rregullimi i oborreve të shkollave,	5
Ndërtimi i rrugës regjionale Lluge- Radeve,	0
Projektet në Magurë, Mirenë, Medvec, Qylagë, Vërshec, Leletiq, Blinajë dhe Vrellë e Goleshit	
Asfaltim i rrugëve,	3
Asfaltimi i rrugës Vërshec-Qylagë,	4
Ndërtimi i stadiumit dhe objekteve përcjellëse në Magure,	0
Asfaltimi i rrugës së varrezave në Medvec,	0
Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik të rrugëve qendrore,	3
Funksionalizimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësve dhe kanalizimeve,	5
Ndërtimi i shkollës në Magure dhe Mirenë,	0

Ndërtimi i Qendrës Rinore në Magure,	2
Renovimi i shtëpisë së kulturës në Vrellë,	0
Dhënia e lokacionit dhe ndërtimi i objekteve të banimit social përmes partneritetit publiko privat në Magure,	0
Rregullimi i shtratit të lumenjve,	3
Rregullimi i shtratit të lumit në Magure dhe rregullimi i parkut-shëtitores,	0
Projektet në Shalë, Kroimir, Baicë, Resinoc, Kleçkë dhe Divjakë	
Asfaltimi i rrugicave,	0
Asfaltimi i rrugës Shalë-Baicë,	0
Zgjerimi dhe riasfaltimi i rrugës në Resinoc,	0
Funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,	4
Ndriçimi publik i rrugëve qendrore,	0
Rregullimi i shtratit të lumenjve,	0
Ndërtimi i terreneve sportive,	0
Përfundimi i sallës së sportit në Shalë,	2

- 85 premtime ose 64.88 % pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
- 4 premtime ose 3.05% ka shenja pozitive në realizimin e premtimit
- 5 premtime ose 3.81 % ku procesi ka filluar në realizimin e premtimit por me ngecje,
- 9 premtime ose 6.87 % procesi ka filluar në rrugë të mirë,
- 12 premtime ose 9.16 % ka hapa konkrete në realizimin e premtimeve,
- 16 premtime ose 12.21 % të realizuar plotësisht.

Vërejtje: Premtimet janë për periudhën katër vjeçare 2013/2017. Deri tani është shpenzuar 1/2 e kohës.

Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit për realizimin e premtimeve



Nga program i kryetarit për zgjedhjet lokale 2013 për qytetin e Lipjanit, si projekte kryesore ishin 13 projekte, ku deri me tani ka realizuar vetëm katër projekte.

PROJEKTET KRYESORE 2014-2017	VOTO 78 LIPJAN	PROJEKTET KRYESORE 2014-2017	VOTO 78 LIPJAN
1. UJË TË PIJSHËM 24 ORË		1. UJË TË PIJSHËM 24 ORË	
2. RRUGË, PARKINGJE DHE TROTUARE		2. RRUGË, PARKINGJE DHE TROTUARE	
3. NDRIÇIMI PUBLIK		3. NDRIÇIMI PUBLIK	
4. RINDËRTIMI I SHESHIT "ADEM JASHARI"		4. RINDËRTIMI I SHESHIT "ADEM JASHARI"	
5. HAPËSIRA TË REJA GJELBËRUESE		5. HAPËSIRA TË REJA GJELBËRUESE	
6. TERRENE SPORTIVE		6. TERRENE SPORTIVE	
7. NDËRTIMI I ÇERDHESE SË RE TË FËMIJËVE		7. NDËRTIMI I ÇERDHESE SË RE TË FËMIJËVE	
8. NDËRTIMI I QENDRËS TREGTARE - ZEJTARE		8. NDËRTIMI I QENDRËS TREGTARE - ZEJTARE	
9. NDËRTIMI I NXEMJES QËNDRORE		9. NDËRTIMI I NXEMJES QËNDRORE	
10. DISLOKIMI I TREGUT TË GJELBËR		10. DISLOKIMI I TREGUT TË GJELBËR	
11. FASADIMI, IZOLIMI DHE MEREMETIMI I NDËRTESAVE NË QYTET		11. FASADIMI, IZOLIMI DHE MEREMETIMI I NDËRTESAVE NË QYTET	
12. HAPËSIRA TË REJA PËR AKTIVITETE RINORE		12. HAPËSIRA TË REJA PËR AKTIVITETE RINORE	
13. AMBIENT TË PASTËR		13. AMBIENT TË PASTËR	

Problemet aktuale

Sikur se edhe në raportet e kaluara monitoruese Komuna e Lipjanit nuk po arrin kurrë se si ti zgjidhë problemet kryesore që po preokupohen qytetarët e Lipjanit, në këtë nuk e ka pas arritur as ekzekutivi i kaluar, por edhe ekzekutivi tanishëm nuk ka bërë as ndonjë përpjekje serioze në zgjidhjen e tri problemeve kryesore që sot qytetarët e Lipjanit preokupohen dhe ato janë:

- Mungesa e ngrohtores së qytetit;
- Kundërmimi nga ferma e pulave;
- Mungesa e përkujdesjes ndaj vendeve turistike dhe historike.

Mungesa e ngrohtores së qytetit. Nuk ka lëvizje në këtë drejtim, edhe pse ne kemi bërë vërejtje që nga raporti e parë mbi punën e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit dhe që është premtim më kryesor nga fushata zgjedhor që nga 2009-ta dhe 2013-tës nga kryetari i komunës Z. Imri Ahmeti.

Kundërmimi nga ferma e pulave. Banorët në dalje të qytetit të Lipjanit, në drejtim të fshatit Banullë, kanë problem kundërmimit të erërave që vijnë nga ferma e pulave që ndodhet në afërsi të udhëkryqit për në Janjevë. Nga erërat që fryjnë, kundërmimi nga ferma e pulave mbërrin deri në qendër të qytetit, por më së shumti kanë problem banorët që ndodhen në afërsi të kësaj ferme.

Mungesa e përkujdesjes ndaj vendeve turistike dhe historike. Në këtë drejtim nuk kemi asnjë ndryshim nga raporti i kaluar.

Transparenca dhe llogaridhënia

Ndër premtimet kryesore të Kryetarit Imri Ahmeti ka qenë edhe transparenca dhe llogaridhënia si dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile. Gjatë kësaj periudhe të raportimit kemi një regres të theksuar, pasi që kryetari Imri Ahmeti i ka mbyllur dyert ndaj organizatave të shoqërisë civile në mbledhjet e Bordit të drejtorëve, kemi ndërprerjen e dërgimit të materialeve të kuvendit për shoqërinë civile, kemi po ashtu kemi mos lejm në qasjen në dokumentet publike për organizatën e vetëm monitoruese YAHR, po ashtu kemi mos publikim të vendimeve për ndarje të subvencioneve nga zyra e kryetarit dhe mos publikimi i këtyre vendimeve lundin dyshime për keq përdorim të parasë publike, etj..

Në ueb faqja e komunës ekzistojnë mangësi në vonesën e informimit të qytetareve dhe mungesën e informacioneve tek profilet e këshilltareve komunal.

Kemi një lëvizje pozitive tek hartimi i planit komunal të veprimit për transparencë, por që ende nuk është finalizuar, e cila është dashur që të jetë produkt i rregullores komunale për transparencë të miratuar nga kuvendi Komunal të datës 30.06.2014 nr. 15-011-24892.

Performanca buxhetore e komunës së Lipjanit


Buxheti i përgjithshëm i komunës së Lipjanit për periudhën Janar-Shtator 2015 ka arrit që të shpenzohet në masën 84.16 % ose 9,280,717.72 € nga buxheti i alokuar prej 11,027,724.07 € ose 74.84 % nga buxheti i përgjithshëm i komunës për vitin 2015, që është 12,399,254.00 €. Kjo shifër është e mirë e arritur në shpenzimin e buxhetit në këtë komunë. Mirëpo, pjesa më e madhe e pritjet të shpenzohen në tre mujorin e fundit të 2015.

Po ashtu e kemi një performancë të mirë edhe në inkasimin e të hyrave vetanake të komunës ku deri me datën 31.10.2015 janë inkasuar 1,124,698.84 euro ose 83.79% nga planifikimi buxhetor që është 1,342,336.00 euro për vitin 2015.

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencione t dhe transfere	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2015	8,297,000▲	956,030▼	198,390▼	157,000▼	2,790,834▼	12,399,254▲
2014	6,793,498▲	983,145▲	256,500▼	200,000▲	3,100,301▼	11,333,444 ▼
2013	6,738,235▲	815,573▲	204,746▲	179,550▲	3,301,197▼	11,973,991▲
2012	6,744,398▲	742,386▼	119,972▼	138,064▲	3,606,440▼	11,795,467.76▲
2011	6,580,682▲	752,815▲	130,707▼	88,273▲	4,113,220▲	11.317.613,69▲
2010	5,069,000▲	698,000▲	133,000▼	78,000■	3,376,000▲	9,456,417 ▲
2009	4,425,264▲	512,394 ▼	112,154■	80,000■	2,325,154▲	7,454,966▲
2008	3,868,282▲	554,288 ▲	112,154▼	80,000■	1,239,909▲	5,854,633▲
2007	3,718,294▼	537,335 ▼	202,154▲	80,000▼	1,127,138▲	5,664,921▲
2006	3,731,341▲	610,147 ▼	78,577▼	100,000▲	1,070,849▼	5,590,914▼
2005	3,696,996 ▼	621,827 ▼	126,381■	64,000■	1,180,077▲	5,689,281▲
2004	3,701,207▲	1,135,854▼	-	-	721,431▲	5,558,492▲
2003	2,770,014■	1,144,006■	-	-	465,113■	4,528,532■

▲ Rritje, ▼ Zvogëlim, ■ Nivel i njëjtë/mos ndryshim

Tabela krahasuese e planifikimeve buxhetore 2012/2015 për Komunën e Lipjanit



Planifikimet buxhetore e komunës së Lipjanit për vitin 2016

Komuna e Lipjanit i ka organizuar gjithsej 14 dëgjime buxhetore për planifikimet buxhetore për vitet 2016/2018, ku 13 prej tyre janë organizuar nga ekzekutivi dhe një nga ana e legjislativit.

Dëgjimet buxhetore janë organizuar këto vendbanime: Gadime ,4 dëgjime buxhetore në Lipjan, Rufc, Dobrajë e madhe, Ribarë i madh, Magure , Sllovi, Janjevë, Akllap, Bainsw dhe Grackë e vjetër.

Është interesante krahasuar me vitet e kaluara për herë të parë kryetari i Komunës së Lipjanit nuk merr pjesë në asnjë dëgjim buxhetore, të gjitha takimet dëgjimet janë organizuar nga ana e drejtorisë komunale për buxhet dhe financa.


Kërkesat e qytetarëve gjatë debateve për planifikimin buxhetor 2016-2018		Rregullimi i shtratit të lumit	Asfaltimi i rrugës të fshatit,	Rregullimin e trotuareve,	Rregullimi e ndriçimit publike në fshat,	Rregullimin e varrezave të fshatit,	Zgjidhjen e problemit me qentë endacak,	Asfaltimin e rrugës Babushë-Cërnillë,	Ndërtimin e fushës sportive	Ndërtimin e një shkolle fillore	Zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit	Rregullimin e ngrrohtore qendrore në shkollë	Zgjidhjen e problemit me mbeturina	Rregullimin e rrethoja të shkollës	Ndërtimin e parketit të shkollës	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit	ujësjellës
1	Gadime	*	*	*	*	*	*										
2	Babushë i muhaxhirëve	*	*					*									
3	Marevc:		*	*													
4	Lipjan:	*	*		*					*							
5	Rufc										*	*	*				
6	Ribarë i vogël;			*					*							*	
7	Dobrajë e madhe														*	*	*
8	Gllancë														*	*	
9	Ribarë i madhë			*		*			*								
10	Zllakuqan				*				*				*				
11	Kroishtë				*								*			*	
12	Magure				*								*				*
13	Leletiq													*		*	*
14	Mirenë									*							
15	Sllovi		*	*								*					
16	Janjevë								*				*				
17	Akllap																*
18	Teqe								*								
	Gjithsej	3	5	5	5	2	1	1	5	2	1	2	5	1	2	5	4

Në bazë të grumbullimit të dhënave dhe gjatë procesit monitoruese, kemi konstatuar se këto janë prioritetet apo kërkesat kryesore të qytetarëve:

- Asfaltimi i rrugës të fshatit,
- Rregullimin e trotuareve,
- Rregullimi e ndriçimit publike nëpër fshatra,
- Ndërtimin e fushave sportive

- Zgjidhjen e problemeve me mbeturina
- Ndërtimin e rrjeteve të kanalizimeve,
- ujësjellës etj.

PRIORITETET E QYTETAREVE



Edhe pse janë organizuar 14 dëgjime buxhetore nga ana e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit, vetëm 1 kërkesë e qytetarëve ose 1.92% është përfshirë në planifikim buxhetor, 9 kërkesa ose 16.66 % nuk dihen saktë a janë të përfshira, sepse me planifikimin buxhetore janë paraparë rregullimi i fushave sportive si tërësi dhe nuk kemi specifikim të saktë të lokacionit të projekteve të parapara, ndërsa 43 kërkesa ose 79.62% nuk janë përfshirë fare në planifikimin buxhetore për vitin 2016.

Investimet kapitale të parapara me buxhetore 2016

	Kostoja totale	Transferim qeveritare	Të hyrat vetanake
Bashkëfinancimi me Donatorë	100,000.00	50,000.00	50,000.00
Mirëmbajtja Investive e Ndriçimit Publik	20,000.00	6,000.00	14,000.00
Mirëmbajtja e rrugëve te asfaltuara	10,000.00		10,000.00
Asfaltimi i Rrugëve brenda Qytetit te Lipjanit	241,000.00	100,000.00	141,000.00
Asfaltimi i Rrugës Blinaje-Qylag	35,000.00	25,000.00	10,000.00
Asfaltimi i Rrugës ne Sllavi ne drejtim te Smallushes	80,000.00	80,000.00	
Asfaltimi i Rrugës dhe infrastrukturës ne Varrezat e Lipjanit	34,000.00	34,000.00	
Ndërtimi I rrjetit te Kanalizimit ne Fshatit Rubovc (2013)	100,000.00	65,000.00	35,000.00
Asfaltimi i Rrugës Glllogovc - Banulle	40,000.00	40,000.00	
Asfaltimi i rrugës Shqipëria-Hajredin Bajrami	291,890.00	291,890.00	

Asfaltimi i Rugës dhe infrastrukturës ne Varrezat ne Medvec	33,000.00	33,000.00	
Asfaltimi i Rugëve ne Fshatin Glogovc	70,000.00	70,000.00	
Asfaltimi i rrugës Dobraj e Madhe - Qylage dhe rrugeve brenda fshatit i Dobraje	115,000.00	100,000.00	15,000.00
Asfaltimi i Rugëve brenda Fshatit Gadimee Ulet Faza II	65,000.00	65,000.00	
Mirëmbajtja Investive e Hapesirave Puplicke	50,000.00		50,000.00
Ndërtimi i Trotuareve në Fshatin Ribar i Vogel	65,000.00	45,000.00	20,000.00
Ndërtimi i Trotuareve në Fshatin Sllovi	75,000.00	75,000.00	
Ndërtimi i Trotuareve në Fshatin Rufc i Vjeter	45,000.00	45,000.00	
Ndërtimi i Trotuareve në Fshatin Glogovc	45,000.00	45,000.00	
Ndërtimi i Trotuareve në Fshatin Llugaxhi	41,000.00	41,000.00	
Ndërtimi i Trotuareve në Fshatin Magure	25,000.00	25,000.00	
Ndërtimi i Trotuareve në Fshatin Ribar i Madh	35,000.00	35,000.00	
Ndërtimi i Shtratit te Lumit ne Fshatin Banulle	25,000.00	25,000.00	
Ndërtimi i Trotuareve ne Fshatin Banulle	45,000.00	45,000.00	
Mirëmbajtja dhe Rehabilitimi i Rrjeteve te Kanalizimeve	20,000.00		20,000.00
Ndërtimi i Rrjetit te Kanalizimit ne Fshatin Janjeve (2013)	100,000.00		100,000.00
Ndërtimi i Rrjetit te Kanalizimit ne Fshatin Mirene	50,000.00		50,000.00
Ndërtimi i Rrjetit te Kanalizimit ne Fshatin Bujari (2015)	93,632.40		93,632.40
Kanalizimi në Fshatin Gadime e Ulët (2011)	54,640.00		54,640.00
Eliminimi i Deponive te Egra	40,000.00		40,000.00
Asfaltimi i rrugëve ne Magure	40,000.00	40,000.00	
Hapja dhe Zhavorrimi i Rugës Hallaq i Madh - Rufc i Ri	20,000.00	10,000.00	10,000.00
Hartimi i projekteve detale	70,000.00	20,000.00	50,000.00
Ndërtimi i Qendrës Rinore në Magure Faza II	348,034.00	177,321.40	170,712.60
Ndërtimi i fushave te vogla sportive	94,415.60	74,415.60	20,000.00
Ndërtimi i Stadiumit te Qytetit	150,000.00		150,000.00
Salla e Sporteve Shale (2011)	90,228.00		90,228.00
Nxemja Qendrore ne Shkollen Filllore Migjeni ne Rufc te Ri, Dobraj e Madhe, Janjeve, Sllovi, Babush, Krojmir, Baice	152,000.00	152,000.00	
Ndërtimi i Rrethojës ne Shkollën Filllore ne Babush	16,000.00	16,000.00	

Drejtoria e prokurimit

Drejtoria Komunale e Prokurimit është përballur me shumë vështirësi gjatë këtij viti 2015. Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2015, kemi 73 tenderi të shpallura nga të cilat kemi 18 tenderë ose 24.65 % prej tyre të ri-tenderuar dhe 47 kontrata të nënshkruara nga operator të ndryshme duke filluar prej furnizimeve me material shpenzues për zyre deri tek investimet kapitale.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe kemi tri vërejtje/opinione nga Agjencia Kundër korrupsionit dhe katër tender të anuluar, me 4 Shkurt 2015 dhe me 4 maj 2015 lidhur me mirëmbajtja e ndriçimit publik në

Komunën e Lipjanit, pastaj me 8 Shtator 2015 - Ndërtimi i Sallës sportive në Fshatin Dobrajë e Madhe faza e II-të dhe me 17 Shtator 2015 - Furnizim me thëngjill për të gjitha shkollat e Komunës së Lipjanit, QKMF-në dhe Shtëpinë e Kulturës dhe lënda është kthyer në ri-tenderim nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

LISTA E TËNDERVE TË KONTRAKTUARA NGA DREJTORIA KOMUNALE E PROKURIMIT NË LIPJAN GJATË PERIUHDHËS JANAR-NËNTOR 2015⁵

Nr.	Nr. i prokurimit	Titulli	Fituesi	Shuma e kontraktuar
1	LI613-15-097-5-2-1	Ndërtimi i rrugëve në Komunën e Lipjanit	Konz. "XHEMA-COM&BLINAJA-AM" Lipjan	14,300.00 €
2	LI613-15-100-5-2-1	Pastrimi dhe hapja e lumejve në fshatrat e Komunës së Lipjanit	NPSH "TOPALLI" - Ferizaj	16,190.00 €
3	LI613-15-095-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Sllavi	"Bageri" -Ferizaj	49,780.50 €
4	LI613-15-076-5-2-1	Ndërtimi i kulmit në shkollën e fshatit Resinoc	N.N.SH "Toni Constuction" Lipjan	6,551.00 €
5	LI613-15-067-1-2-1	Furnizimi me thëngjill për shkollat, QKMF-në dhe shtëpinë e Kulturës	NTP "Metali"-Pozhoran	47,132.00 €
8	LI613-15-075-5-2-1	Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Dobrajë e Madhe	SHPK "Dini - ST" Lipjan	76,132.50 €
9	LI613-15-070-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadime e Ulët	"Papenburg& Adriani	76,881.00 €
10	LI613-15-077-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dobrajë e Madhe- Faza e II	NNT "Burimi" - Malishevë	75,128.63 €
11	LI613-15-055-5-2-1	Rregullimi i hapsirave publike në rrugët "Avdi Kelmendi", "Komandant Kumanova" dhe "Lidhja e Prizrenit" në qytetin e Lipjanit.	"Eing com" Podujevë	96.443.00 €
12	LI613-15-085-5-2-1	Ndërtimi i urës dhe shtratit të lumit në fshatin Sllavi	"Linda" shpk Ferizaj	35,274.36 €
13	LI613-15-057-1-2-1	Furnizimi me dru për shkollat, QKMF-në dhe Shtëpinë e Kulturës	NTSH "Bushgegu" Prishtinë	80,892.72 €
14	LI613-15-066-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Ribar i Madh- Faza e II	N.P.SH "Bageri" Ferizaj	64,199.85 €

⁵ Shënime të marrë nga ueb faqja zyrtare e KRPP-së (Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik të Kosovës) deri në ora 19.55 të datës 27.11.2015.

15	LI613-15-075-5-2-1	Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Dobrajë e Madhe	Toni Construcion&Alfa Produukt” Lipjan	93,173.00 €
16	LI613-15-072-5-2-1	Pastrimi dhe hapja e lumejeve në fshatrat Ribar i Madh dhe Gllgovc	“Ferizi” - Lipjan	15,400.00 €
17	LI613-15-074-5-2-1	Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në fshatrat Kraishtë, Ribar i Madh, Ribar i Vogël, Poturovc, Torinë Dobrajë e Madhe dhe Llugë Faza e dytë –Kontratë dyvjeçare	Xhema com&Arhigo-Lipjan	49,345.40 €
18	LI613-15-060-5-2-1	Ndërtimi i tretarëve në qytetin e Lipjanit- segmentet rrugore “Skënderbeu”, “Fehmi Agani” dhe “2 Korriku”	NTP “Beli”, Malishevë	99,417.35€
19	LI613-15-034-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Magurë	“Papenburg&Adriani company” SHPK- Ferizaj	83,696.00 €
20	LI613-15-073-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bujan	“Papenburg&Adriani company” SHPK- Ferizaj	37,857.00 €
21	LI613-15-037-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadime e Epërme	“Bageri”NPSH- Ferizaj	48,914.50 €
22	LI613-15-057-1-2-1	Furnizimi me dru për shkolla, QKMF-në dhe Shtëpinë e Kulturës	NTSH“Nazi Travel & Meti Comerc” Magjistranja Prishtinë - Ferizaj	70,297.20 €
23	LI613-15-003-2-2-1	Mirëmbajtja e ndriçimit Publik në Komunën e Lipjanit	M.V.R. “Elektromontues”- Prishtinë	7,321.60€
24	LI613-15-025-5-2-1	Zgjërimi i rrjetit të kanalizimit në fsh. Dobrajë e Madhe, Ribar i Madh dhe Shalë	“Eing Com” NNT, Podujevë	29,824.20 €
25	LI613-15-037-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadime e Epërme	“Bageri”NPSH- Ferizaj	48,914.50 €
26	LI613-15-051-5-2-1	Rehabilitimi i kanalizimit në fshatin Bujari- Faza e dytë –Kontratë dyvjeçare	N.N.P “Ferizi”- Gllgovc-Lipjan	113,648.00 €
27	LI613-15-038-2-2-1	Mirëmbajtja e rrjetit ekzistues të Kanalizimit në Komunën e Lipjanit	“Xhema Com” Gadime, Lipjan	5,418.40 €
28	LI613-15-046-5-2-1	Rregullimi i parkingjeve në Komunën e Lipjanit	NTP “Rexha com” Lipjan	14.632.40 €
29	LI613-15-032-5-2-1	Rregullimi i vendndaljes së autobusëve tek Qendra Rinore Sportive në Lipjan	NTP “Studio Hapsira” Prishtinë	18,516.00 €
30	LI613-15-044-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Krojmir, lagjësja Pojata	“Bageri” Ferizaj	52,550.00 €

31	LI613-15-048-5-2-1	Asfaltimi dhe rrethoja e fushës së futbollit në fshatin Sllovi	N.N.P ATC-COM- Kaçanik	19,512.37 €
32	LI613-15-045-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Baincë	“Eskavatori” SHPK- Ferizaj	53,867.45 €
33	LI613-15-030-5-2-1	Asfaltimi i rrugës “Isa Boletini” në fshatin Ruvç i Ri	“Dekor Grup&Burimi” Prishtinë	35,535.40 €
34	LI613-15-026-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Janjevë	NT “Rahovica Comerc” Ferizaj	49,283.75 €
35	LI613-15-033-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve Sllovi - Smallushë	“Eskavatori SHPK” Ferizaj	82,863.30 €
36	LI613-15-023-5-3-1	Rehabilitimi i ndriçimit Publik në fshatin Grackë e Vjetër	D.P.T “Elektrika mont”- Lipjan	5,569.00€
37	LI613-15-014-5-2-1	Lot 1 • Riparimi dhe ndërtimi i shkallëve në shkollën fillore “Fehmi Agani”- Medvec dhe riparimi i tavanit në korridorin e Shkollës, rregullimi i platosë dhe rrugica-trotuari në SHFMU “Vezir Kolshi” në Baincë dhe Lot 2 • Rregullimi i fushës me beton në shkollën fillore “Shtjefan Gjeqovi” në Janjevë, paralelja e ndarë në Brus; Rregullimi i platosë, trotuarit dhe shtruarja e betonit rreth temelit të shkollës “2 Dëshmorët” në Dobrajë të Madhe si dhe ndërtimi i platosë dhe trotuarit në SHFMU “Migjeni”-Ruvç	” TINi” për Lot I – Prizren dhe” Studio Hapësira”- Prishtinë për Lot II	4893.10 € Lot I dhe 13201,96 € Lot. II
38	LI613-15-012-5-2-1	Ndërtimi i rrethojave në disa shkolla të Komunës së Lipjanit	NTP” Ferizi” Lipjan, për Lot I Pro Ing&Korabi –Drenas, për Lot II Pro Ing&Korabi –Drenas, për Lot III NTP”Edi Kon” –Drenas, për Lot IV “Rexha” SHPK –Prishtinë, për Lot V	17,234.40€ Lot I, 15,943.40€ Lot II, 23,683.40€ Lot III, 12,143.00€ Lot IV, 12,095.00€ Lot V
39	LI613-15-029-2-2-1	Shërbime me aparate të fotokopjes për institucionet Komunale	NTSH “Rikon” Prishtinw	4976.52€
40	LI613-15-013-5-2-1	Renovimi i kulmit dhe ndërimi i dyerve dhe dritareve në shkollën fillore “Rexhep Akllapi” në Akllap	” Euro-Projekt” - Prishtinë	14,182.92 €

41	LI613-15-031-5-2-1	Renovimi i qendrës kulturore “Tahir Sinani” Lipjan	N.N. “Global-ing” Pakashticë e Poshtme , 42Podujevë	16425.90€
42	LI613-15-018-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Brus	Sh.p.k “Beni-Com” Prishtinë	48,305.50 €
43	LI613-15-015-1-2-1	Furnizimi me material zyre Lot I dhe Furnizimi me toner Lot II	NTGi” Grafo Loni” për Lot I dhe NTGi” Grafo Loni” për Lot II	224.90€ Lot I dhe 789.20 € Lot II
44	LI613-15-010-2-2-1	Shërbime të byfësë për stafin Komunal	D.P.H “Visari” Lipjan	41.20 €
45	LI613-15-004-2-2-1	Sigurimi i automjeteve nga auto përgjegjësia ndaj palëve të treta	Kompania e Sigurimeve “Sigkos” Sh.a.	26,204.40€
46	LI613-15-003-2-2-1	Mirëmbajtja e ndriçimit Publik në Komunën e Lipjanit	D.P.T “Elektrika mont”- Lipjan	1835.80€
47	LI613-15-083-1-2-1	Furnizimi me ushqim i Qendrës për Edukim Parashkollor Lot I dhe Furnizimi me material higjenik për Institucionet Komunale Lot II	NTP” Pashtriku” për Lot I dhe NTP” Pashtriku” për Lot II	39,835.00.€ Lot I dhe 4,986.95€ Lot II

Arsimi

Me nisjes së mandatit të parë të kryetari aktual Imri Ahmeti, sistemi arsimor në Lipjan është përballur me këto probleme kryesore:

1. Gjendja jo e mirë e infrastrukturës shkollore;
3. Numri i madh i nxënësve për paralele në shkollat e mesme;
3. Mungesa e laboratorëve dhe hapësirave për mësim praktik;

Po ashtu, ndër problemet tjera që janë evidentuara në këtë vit 2015, janë se pjesa dërmuese e shkollave në Komunën e Lipjanit janë në gjendje të keqe infrastrukturore .

Problemet të cilët aktualisht hasën në sistemin arsimor në Lipjan janë ato në shkollat e mesme, përkatësisht me numrin e madh të nxënësve në to që në shumicën e rasteve ky numër është afërsisht 40 nxënës për një klasë dhe po ashtu problem në vete paraqet mungesa e laboratorëve dhe hapësirave për mësim praktik.

Numri i nxënësve dhe i personelit arsimor në Komunën e Lipjanit ⁶				
Arsimi Komunal			Personeli	
	Nr.	i	Nr. i nxënësve	Nr. i
			Nr. i	Nr. i

⁶ http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Shenime_Statistikore%202014-15_Arsimi_Parauniversitar.pdf

	institucioneve		Mësimdhënësve	personelit tjetër
Institucione parashkollore publike	1	114	8	9
Shkolla fillore publike	51	10211	674	158
Shkolla të mesme publike	3	2688	183	32
Shkolla apo kolegje private	1	/	/	/
Gjithsej	56			

Shëndetësia

Po ashtu është shqetësuese gjendja në sektorin e shëndetësisë, për kundër angazhimeve të shumta të Drejtorisë Komunal për Shëndetësi në Komunën e Lipjanit, që të përmirësojë gjendjen ekzistuese në sektorin shëndetësor, prapë se prapë gjendja ka qenë katastrofale në këtë sektor, me fajin e Ministrisë së Shëndetësisë. Ka pasur mungesë të gjerave elementare duke filluar nga shiringat, gypin përcjellës për infuzione, dorëzat sterilizuese për personelin mjekësorë, fashat, cilindrin mbushës me oksigjen dhe plotë gjëra të tjera që i duhen një pacienti për të marrë një intervenim emergjent. Me këtë përveç që pacient do të kishte shpenzime materiale , ata rrezikohen edhe me humbjen e kohës për të marrë ndonjë intervenim mjekësorë për shëndetin e tij dhe njëkohësisht me këtë i rrezikohet edhe jeta e tij në raste të rënda.

Pas thirrjes së organizatës sonë ndaj ekzekutivit të Komunës së Lipjanit që të angazhohet maksimalisht në kujdesin shëndetësor për qytetarët e vetë, drejtoria komunale e shëndetësisë është përgjigjur pozitivisht, duke ndarë mjete buxhetore për plotësimin e këtyre mungesave të medikamenteve e cila është si pasojë e një menaxhim të keq nga Ministria e Shëndetësisë.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Komunën e Lipjanit përlllogariten sipas Rregullores komunale mbi pronën. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i ka caktuar tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore.

Rekomandimet:

1. Angazhim më i madh i Kryetarit të Komunës në përmbushjen e premtimeve elektorale;
2. Menaxhim më i mirë dhe transparencë më e madhe në shpenzimin e fondeve publike;
3. Ofrim i qasjes në informacion dhe dokumentacion për të gjitha palët e interesuara;
4. Komunikim më kualitativ me shoqërinë civile dhe media;
5. Organizimi më i shpeshtë i takimeve publike me qytetarë veçanërisht në fazën e përpilimit të projekteve kapitale dhe buxhetit komunal;
6. Marrja parasysh e propozimeve të qytetarëve për investime kapitale sipas mundësive buxhetore;

7. Në fillim të vitit të paraqitet në Kuvendin Komunal, Plani Dinamik i realizimit të projekteve nga Lista e Investimeve Kapitale;
8. Mbikëqyrje më efikase e realizimit të punëve në projektet kapitale, veçanërisht në projektet infrastrukture;
9. Mbrojtje më e mirë e pronës publike mbi baza ligjore ,
10. Përmirësimi i bazës të dhënave mbi tatimin në pronë,
11. Kuvendi Komunal I Lipjanit është i obliguar të hartojë një plan të veprimit për transparencë të aktiviteteve të saj karshi qytetarëve të saj.
12. Integrimin e një programi kompjuterikë kontabiliteti të brendshëm që do të siguronte informacione për qëllime raportimi në kohë, të plotë dhe të saktë,

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shkurt-Qershor, 2015.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2015. (<http://mefrks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2012-2014 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2013 “Jeta në Kosovë”, www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2012.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunitet e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2013.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2013. Janar, 2014.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2014. Shtator, 2014.
12. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndhmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2014.
15. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2015.
16. Programi zgjedhor i LDK-së dega Lipjan , Nëntor 2013,
17. Raporti Komunal Lipjan i Institutit për studime të Avancuara GAP , 2014,
18. Zyra Komunale për punësim në Lipjan. Maj 2012,
19. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Janar-Dhjetor2015,
20. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit Janar-Dhjetor2015,
21. Komunikatat për media të YAHR-it Janar-Dhjetor2015.
22. <https://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/President/Biografia-e-Kryetarit.pdf.aspx>,
23. <http://zgjedhjet2013.weebly.com/programet-e-partive-politike-peumlr-zgjedhjet-2013.html>,
24. <http://zgjedhjet2013.weebly.com/tv-debatet.html>,
25. <https://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/President/President-Report/Raporti-per-Vitin-2014.pdf.aspx>,

